

Programi

SIGURI KIBERNETIKE

Shkolla e parë e lartë profesionale, për studime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.



+383 (0) 38 600 237

www.cactus.educationapply@cactus.education

Prishtinë dhe Prizren



Cactus Education është shkollë e lartë profesionale e nivelit të V e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe e licencuar nga MASHT-i.

Programi: Siguri Kibernetike

Programi për drejtimin “Siguria Kibernetike” është dizajnuar që të përgatitë kandidatët për të filluar dhe ndërtuar karrierë në siguri kibernetike si anëtar i ekipit në kompani ose si i vetëpunësuar.

Programi ofron njohjen në siguri kibernetike duke përfshirë sigurinë e informacionit, sigurinë e rrjetave, sigurinë e aplikacioneve ueb dhe mobile dhe përgatitjen për testime profesionale të sigurisë kibernetike. Duke filluar nga bazat e rrjetave, bazat e sistemeve operative si Linux dhe Windows, kandidatët do të aftësohen edhe të operojnë me mjete të sigurisë si: Kali Linux, Metasploit Framework, Nmap, BurpSuite, Firewalls, IDS/IPS, Firewalls të Uebfaqeve, si dhe teorinë kryesore për ndërmarrësi dhe inovacion, modelet e biznesit, burimet e financimit të biznesit, etj.

Programi ndërthur paraqitjen e koncepteve teorike me ushtrimet laboratorike dhe detyrat reale të punës praktike që nga dita e parë. Kandidatët që e kryejnë këtë program janë kompetitivë dhe të krahasueshëm me punëtorët e kësaj lëmie që kanë përvojë praktike 2-vjeçare. Ata janë në gjendje të kryejnë detyrat e punës me mbikëqyrje minimale, kanë shkathtësi dhe aftësi për të zgjidhur problemet praktike në mënyrë kritike dhe kreative, kanë bazamentin e mjaftueshëm teorik dhe janë të hapur për mësim dhe ide të reja në rrugëtimin e pandalshëm të zhvillimit teknologjik.

Programi “Siguria Kibernetike” përgatitë kandidatët me shkathtësi si:

- Analist i sigurisë së informacionit
- Analist i Rreziqeve Kibernetike
- Specialist i sigurisë së informacionit
- Administrues i Sistemeve të Sigurisë
- Testues i Cënushmërisë (Penetration tester)
- Kriptografi
- Siguria në Teknologjinë Cloud
- Gjuhët programuese (skriptuese)
- Mbrojtja e Rrjetit
- Mbrojtja e të Dhënave
- Zbulimi dhe Përgjigja ndaj Incidenteve
- Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike
- Hulumtues i sigurisë
- Njohuri në standarde dhe korniza të sigurisë Kibernetike

Kohëzgjatja:

Programi ‘Siguria Kibernetike’ është program dy vjeçar i ndarë në 4 semestra; Viti i parë përmban 60 ECVET kredi dhe viti i dytë 60 ECVET kredi. Rrjedhimisht, fondi i përgjithshëm i orëve për katër semestrat e shkollimit të këtij profili për të gjitha lëndët është 2,400 orë, respektivisht 120 ECVET kredi (1 ECVET – 20 orë) sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës.

Metodologjia e mësimit:

Programi është i strukturuar me qëllim që të sjellë një simulim të vërtetë të ambientit të punës në industrinë e teknologjisë. Rëndësia e aspektit teorik dhe akademik në program është e theksuar, duke u përqendruar në përdorimin e një qasjeje të ngjashme me atë që gjen në fushën e punës për të zhvilluar profesionistë dhe udhëheqës të ardhshëm në këtë industri. Metoda e punës në klasë synon të ndërtojë dijen e kandidatëve mbi bazën e njohurive të tyre të fituara nga mësimi paraprak i materialeve mësimore.

Programi përqendrohet që kandidatët t’i aftësojë se si të përballen me sfidat dhe kërkesat që do të kenë në të ardhmen e tyre: të aftësohen në aspektet se si mësohet, si gjendet informata, si të bëhen konkurrent në vendin e punës por edhe në tregun global, si të bëhen kritik dhe kreativ, si të bëhen produktiv për shoqërinë dhe për botën në përgjithësi.

Mësimi praktik bazohet në përvojën e drejtpërdrejtë të kandidatëve me situata reale dhe detyra praktike që ata do të përballen në karrierën e tyre të ardhshme. Ky lloj mësimi inkurajon angazhimin aktiv të kandidatëve dhe zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për të aplikuar njohuritë teorike në situata praktike. Mësimi praktik përfshinë elementet si: Projekte praktike, Simulime dhe skenarë, Studime rastesh, Demonstrim.

Lista e moduleve të drejtimit “Siguria Kibernetike”

Moduli	Semestri	ECVET
Gjuhë angleze për TI	I	4
Matematika për shkencat kompjuterike	I	6
Bazat e TIK	I	8
Rrjetat Kompjuterike 1	I	6
Hyrje në programim	I	6
Rrjetat Kompjuterike 3	III	6
Linux 2	III	6
Administrim i bazave të të dhënave	III	6
Siguria e Informacionit	III	7
Lëndë zgjedhore	III	4

Moduli	Semestri	ECVET
Rrjetat Kompjuterike 2	II	6
Linux 1	II	7
Teknologjitë Cloud	II	7
Gjuhë skriptuese	II	6
Lëndë zgjedhore	II	4
Virtualizim	IV	6
Siguria Kibernetike	IV	7
Operacionet Kibernetike/ Cyber Operations	IV	7
Testimi i Sigurisë/ Penetration Testing	IV	7
Lëndë zgjedhore	IV	4

Lëndët Zgjedhore

Moduli	Semestri	ECVET
Hyrje në biznes	Z	4
Hyrje në shitje	Z	4
Menaxhimi i projekteve në TI	Z	4
Testimi i Softuerit	Z	4
Intelegjenca Artificiale	Z	4
Ndërmarrësia dhe inovacioni	Z	4
Marketingu Digjital	Z	4

1. Gjuhë angleze për TI

Moduli ofron pjesë teorike dhe praktike për t'i pajisur kandidatët me njohuri thelbësore të terminologjisë së gjuhës angleze në fushat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, si fusha e programit, rrjetave, sistemeve, etj. Kandidati do të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë literaturën dhe materialet nga fusha e TI-së, specifikacionet teknike, dokumentacionin e projekteve të TI-së. Do të jetë i aftë të hartojë draftet e specifikacioneve, dokumentacionin dhe ofertat për produkte dhe shërbime të TI-së dhe t'i komunikojë ato në gjuhën angleze me gojë dhe me shkrim.

2. Matematikë për shkencat kompjuterike

Qëllimi kryesor i lëndës është mësimi i parimeve themelore të matematikës të cilat kanë të bëjnë me të gjitha fushat, veçanërisht me shkencat kompjuterike. Kandidatët do të forcojnë njohuritë e tyre nga shkolla e mesme duke mësuar bazat e llogaritjes dhe bazat e matematikës diskrete dhe do të mësojnë se si t'i zbatojnë ato në fushën e shkencave kompjuterike. Moduli përfshin tema nga: logjika matematike; bashkësitë; relacionet; pasqyrimet (funksionet); parimet elementare të numërimit; kuptimet themelore të teorisë së numrave; mosbarazitë elementare dhe teorinë themelore të grafeve.

3. Bazat e TIK

Ky modul synon të shërbejë si një hyrje në arkitekturën, strukturën, funksionet, komponentët dhe modulet e pajisjeve kompjuterike, duke ofruar njohuri mbi konceptet bazë të kësaj teknologjie. Moduli ofron një hyrje gjithëpërfshirëse në industrinë e IT-së dhe ekspozimin e thellë ndaj kompjuterëve personalë, harduerit dhe sistemeve operative. Kandidatët mësojnë se si funksionojnë komponentët e ndryshëm të harduerit dhe softuerit dhe praktikën më të mira në mirëmbajtje dhe siguri. Nëpërmjet aktiviteteve praktike, laboratorike, kandidatët mësojnë se si të montojnë dhe konfigurojnë kompjuterët, të instalojnë sisteme operative dhe softuerësh dhe të zgjidhin problemet e harduerit dhe softuerit si dhe konceptet e rrjetave.

Moduli: IT Essentials: <https://www.netacad.com/courses/os-it/it-essentials>

Ky modul përgatitë kandidatët për çertifikim në CompTIA A+.

4. Rrjetat Kompjuterike 1

Rrjetat Kompjuterike 1 mbulon arkitekturën, strukturën, funksionet dhe komponentët e internetit dhe rrjeteve të tjera kompjuterike. Kandidatët arrijnë një kuptim bazë të mënyrës se si funksionojnë rrjetet dhe si të ndërtojnë rrjete të thjeshta lokale (LAN), të kryejnë konfigurime bazë për ruterat dhe ndërprerësit dhe të zbatojnë Protokollin e Internetit (IP).

Moduli Rrjeta kompjuterike 1 mësohet përmes Cisco Networking Academy, CCNA: Introduction to Networks.

5. Hyrje në Programim

Ky modul mundëson, përdorimin e gjuhëve programuese Java, ashtu që kandidatët do të fitojnë njohuri në konceptin e programimit kompjuterik, duke shfrytëzuar gjuhën programuese Java si mjet kryesor të zhvillimit, për të zgjidhur problemin, mësimin dhe praktikimin e komponentëve themelore të procesit të programimit, leximin dhe “debug”imin e programit në Java, kuptimin e sintaksës së gjuhës programuese Java.

6. Rrjetat Kompjuterike 2

Ky modul fokusohet në teknologjitë Switching & Routing dhe operacionet e ruterit që mbështesin rrjetet e biznesit të vogël dhe të mesëm. Ai përfshin rrjetet lokale pa tel (WLAN) dhe konceptet e sigurisë. Kandidatët mësojnë konceptet e ndërrimit të çelësave dhe rrugëtimit. Ata mund të kryejnë konfigurimin bazë të rrjetit dhe zgjidhjen e problemeve, të identifikojnë dhe të zbusin kërcënimet e sigurisë së LAN dhe të konfigurojnë dhe sigurojnë një WLAN bazë. Switching, Routing, and Wireless Essentials (SRWE) mbulon arkitekturën, komponentët dhe funksionimin e ruterave dhe ndërprerësve në rrjete të vogla dhe prezanton rrjetet lokale pa tel (WLAN) dhe konceptet e sigurisë. Kandidatët mësojnë se si të konfigurojnë dhe zgjidhin problemet e ruterave dhe çelësve për funksionalitet të avancuar duke përdorur praktikën më të mirë të sigurisë dhe të zgjidhin problemet e zakonshme me protokollin si në rrjetet IPv4 ashtu edhe në IPv6.

Moduli Rrjeta kompjuterike 2 mësohet përmes Cisco Networking Academy, CCNA: Switching, Routing, and Wireless Essentials.

7. Linux 1

Moduli Linux është krijuar për kandidatët e TIK pa përvojë të mëparshme të administrimit të sistemit Linux. Moduli u ofron kandidatëve kompetencën e administrimit të Linux duke u fokusuar në detyrat kryesore të administrimit. Ky modul gjithashtu ofron një bazë për kandidatët që planifikojnë të bëhen administratorë të sistemit Linux me kohë të plotë duke prezantuar konceptet kryesore të linjës së komandës dhe mjetet e nivelit të ndërmarrjes. Gjatë këtij moduli do ta shikojmë sintaksën për administrimin e Linux në terminal, instalimin e softuer-ave të ndryshëm, krijimin dhe administrimin e Logical Volume, bash skriptave, konfigurimin e firewall dhe aplikimi i qasjeve në dokumenta dhe direktori. Kjo pasqyrë e përgjithshme e sistemeve operative Linux përfshinë tema që ndihmojnë kandidatët në përgatitjen e çertifikimeve në CompTIA Linux +, LPIC-1 dhe RHCSA. CompTIA Linux+.

8. Teknologjitë Cloud

Ky modul përgatitë kandidatët për teknologjitë cloud, në veçanti Azure. Kandidatët, do të mësojnë të zbatojnë, menaxhojnë dhe monitorojnë identitetin, qeverisjen, ruajtjen, llogaritjen dhe rrjetet virtuale në një mjedis cloud. Për të siguruar funksionimin dhe performancën e duhur, administratori Azure do të kujdeset për madhësinë, monitorimin dhe rregullimin e burimeve sipas nevojës. Kandidatët që studiojnë këtë modul do të përfitojnë njohuri dhe ekspertizë të thellë në zbatimin, menaxhimin dhe monitorimin e mjedisit Azure të një organizate, duke përfshirë:

- Konfigurimin e rrjeteve virtuale
- Ruajtjen e të dhënave dhe menaxhimin e magazinimit
- Llogaritjet dhe menaxhimin e burimeve kompjuterike
- Identitetin dhe menaxhimin e qasjes së përdoruesve
- Sigurinë e infrastrukturës dhe të dhënave në Azure.

Moduli përgatitë kandidatët për çertifikim në: Microsoft Azure Fundamentals dhe Microsoft Azure Administrator.

9. Gjuhë Skriptuese

Në këtë Modul, kandidatët do të zbulojnë thellësinë dhe fleksibilitetin e gjuhës Python, duke filluar nga sintaksa bazike dhe strukturat kontrolluese, deri te funksionet, modulet dhe zhvillimi i një aplikacioni të vogël. Përmes mësimave praktike dhe projekteve, ata do të fitojnë aftësinë për të shkruar dhe të kuptuar kodin skriptues, si dhe për të zgjidhur probleme duke përdorur konceptet themelore të programimit.

10. Rrjetat Kompjuterike 3

Ky modul përshkruan arkitekturat dhe konsideratat që lidhen me projektimin, sigurimin, funksionimin dhe zgjidhjen e problemeve të rrjeteve të ndërmarrjeve. Ky modul mbulon teknologjitë e rrjetit të gjerë (WAN) dhe mekanizmat e cilësisë së shërbimit (QoS) të përdorura për akses të sigurt në distancë. Gjithashtu prezanton konceptet e rrjeteve, virtualizimit dhe automatizimit të përcaktuara nga softueri që mbështesin digjitalizimin e rrjeteve. Kandidatët fitojnë aftësi për të konfiguruar dhe zgjidhur problemet e rrjeteve të ndërmarrjeve dhe mësojnë të identifikojnë dhe mbrojnë kundër kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Ata njihen me mjetet e menaxhimit të rrjetit dhe mësojnë konceptet kryesore të rrjeteve të përcaktuara nga softueri, duke përfshirë arkitekturat e bazuara në kontrollues dhe se si ndërfaqet e programimit të aplikacioneve (API) mundësojnë automatizimin e rrjetit.

Moduli Rrjeta kompjuterike 3 mësohet përmes Cisco Networking Academy, CCNA: Enterprise Networking, Security, and Automation.

Pas përfundimit të moduleve Rrjeta 1, Rrjeta 2, Rrjeta 3 kandidati përgatitet poashtu për çertifikim për CCNA Implementing and Administering Cisco Solutions.

11. Linux 2

Moduli përgatitë kandidatët për administrim të avancuar të Sistemeve Operative Linux. Moduli eksploron motorin Ansible për sistemin operativ Linux, kupton komponentët thelbësorë të Ansible, krijon lojëra dhe libra lojërash Ansible, menaxhimin e inventarit, grumbullon fakte nga shpërndarja e shumëfishtë e Linux, administron pajisje të shumta Linux nga motori Ansible. Moduli ka informacion të mjaftueshëm për të zotëruar kandidatët me mjetet e automatizimit, për të menaxhuar një numër të madh serverësh Linux, për të automatizuar konfigurimin e rrjetit dhe pikën hyrëse për integrimin e vazhdueshëm dhe shpërndarjen e vazhdueshme CI/CD.

Përmes këtij moduli kandidatët poashtu përgatitën për certifikim në Red Hat Certified Engineer 8, LPIC-2 dhe LFCS, duke ju siguruar një bazë të fortë për karrierën tuaj në administrimin e sistemeve operative Linux.

12. Administrimi i bazave të të dhënave

Përmes këtij moduli kandidatët mësojnë bazat e koncepteve të bazës së të dhënave në një mjedis cloud, marrin aftësi bazë në shërbimet e të dhënave në Cloud dhe ndërtojnë njohuritë e tyre themelore për shërbimet e të dhënave në Cloud brenda Microsoft Azure.

Ky modul u ofron kandidatëve njohuri dhe aftësi për të administruar një infrastrukturë të bazës së të dhënave SQL Server për bazat e të dhënave relacionale në Cloud, në mjedise hibride dhe që punojnë me ofertat e bazës së të dhënave relacionale të Microsoft PaaS. Për më tepër, ai do të jetë i dobishëm për individët që zhvillojnë aplikacione që ofrojnë përmbajtje nga bazat e të dhënave relacionale të bazuara në SQL.

Përmes këtij moduli kandidatët poashtu përgatitën për certifikim në: Microsoft Azure Data Fundamentals; Administering Microsoft Azure SQL Solutions; Querying Data with Microsoft Transact-SQL.

13. Siguria e Informacionit

Moduli Siguria e Informacionit synon të ofrojë njohuri dhe kuptim të thellë për konceptet, teknikat, dhe praktikën për të siguruar, mbrojtur, dhe menaxhuar sigurinë e të dhënave dhe resurseve informative në mjediset e organizatave moderne. Qëllimi kryesor i këtij moduli është të pajisë kandidatët me një kuptim të thellë të kërcënimeve të sigurisë informative, si dhe me aftësi për të përdorur mjete dhe teknologji për të zbatuar masat e sigurisë e për të parandaluar incidentet e sigurisë së informacionit. Përmes këtij moduli, kandidatët mësojnë të identifikojnë rreziqet potenciale, të zhvillojnë strategji për mbrojtjen e informacionit, të menaxhojnë incidentet e sigurisë, dhe të përmbushin standardet dhe rregulloret e sigurisë informative në përputhje me nevojat e organizatës dhe industri.

14. Virtualizimi

Qëllimi i këtij moduli është përgatitja për të instaluar, konfiguruar dhe menaxhuar suksesshëm një infrastrukturë virtualizimi me platformën Microsoft Hyper-V dhe VMware vSphere. Kandidatët do të zhvillojnë njohuri thelbësore dhe aftësi për të kuptuar dhe për të punuar me komponentët kryesore të vSphere, duke përfshirë vCenter Server, ESXi, Storage, Networking, dhe Security. Moduli siguron një bazë të fortë për të punuar në administrimin e mjedisve të virtualizuara, duke përgatitur profesionistët për të i'u përshtatur nevojave të organizatave në adoptimin dhe menaxhimin e teknologjive të virtualizimit.

Moduli ndihmon kandidatët të përgatiten për çertifikim në Microsoft Hyper-V dhe VMware vSphere.

15. Siguria Kibernetike

Siguria Kibernetike është modul bazë në fushën e sigurisë kibernetike, e dizajnuar për të vlerësuar njohuritë dhe aftësitë themelore të sigurisë së rrjetit. Moduli përfshin temat kryesore të sigurisë së informacionit, duke përfshirë identifikimin e rreziqeve, menaxhimin e identitetit dhe qëndrueshmërinë e rrjetit. Qëllimi i këtij moduli është të sigurojë një bazë të fortë për njohuri dhe aftësi themelore në fushën e sigurisë kibernetike. Ky modul vlerëson aftësitë e kandidatëve për të identifikuar, monitoruar dhe parandaluar kërcënime të sigurisë në ambiente të ndryshme të rrjetit.

Kandidatët përmes këtij moduli përgatiten për Çertifikim në CompTIA Security+, çertifikim që përgatitë profesionistët për të përmbushur kërkesat e një gamë të gjerë të roleve në sigurinë kibernetike.

16. Operacionet Kibernetike

Operacionet Kibernetike është modul i dizajnuar për profesionistët e sigurisë së informacionit, duke u fokusuar në menaxhimin e incidenteve dhe analizën e të dhënave të sigurisë në rrjete të kompjuterëve. Moduli trajton koncepte të sigurisë së rrjetit, si dhe teknologjitë dhe mjetet e nevojshme për të zbuluar dhe parandaluar sulmet kibernetike. Përfundimi i këtij moduli siguron njohuri dhe aftësi të nevojshme për të menaxhuar efektivisht incidentet e sigurisë dhe për të mbrojtur infrastrukturën e rrjetit nga kërcënimet kibernetike.

Kandidatët përmes këtij moduli përgatiten për çertifikim në Cisco Certified CyberOps Associate.

17. Testimi i Sigurisë/Penetration Testing

Qëllimet kryesore të këtij moduli mbi Penetration Testing janë fuqizimi i kandidatëve me një kuptim të thellë të parimeve të Testimeve të sigurisë, pjesës etike dhe ligjore dhe mësimin e raportimit dhe analizës së rezultateve. Nëpërmjet projekteve praktike dhe analizave kritike, kandidatët do të mësojnë të testojnë sigurinë e ndonjë entiteti, gjetjen e dobësive me metodologji profesionale dhe raportimin e tyre sipas bazave ligjore dhe etike. Duke u përqendruar në vlerësimet praktike dhe në mjetet praktike, Penetration Testing fokusohet në gjetjen dhe menaxhimin e dobësive në rrjet, duke u dhënë njohuri të avancuara kandidatëve në industrinë e sigurisë së informacionit.

Moduli gjithashtu përgatitë kandidatët për çertifikim në CompTIA Pentest+.

18. Hyrje në biznes

Ky modul ofron një pasqyrë të koncepteve themelore në biznes, duke përfshirë krijimin, menaxhimin, marketingun, financat, operacionet dhe etikën në aspektet e biznesit. Do të mësohen edhe elementet esenciale si krijimi i një biznes plani, analiza e biznesit dhe hulumtimi i tregut. Kandidatët do të eksplorojnë rolin e biznesit në shoqëri dhe do të zhvillojnë njohuritë bazë për parimet dhe praktikatat kyçe në fushën e biznesit. Qëllimi i këtij moduli është të ofrojë një kuptim themelor të botës së biznesit për kandidatët, duke i përgatitur ata për të kuptuar dinamikën dhe sfidat e tregut të biznesit.

19. Hyrje në shitje

Moduli do t'i ndihmojë kandidatët dhe do të zgjerojë kuptueshmëritë mbi hulumtimin e tregut, segmentimin e tij, të kuptuarit e procesit të shitjes, dallimin në mes marketingut dhe shitjes, menaxhimin e relacioneve me klient, bazuar në industrinë e veçanta, duke filluar nga zanafilla e një kompanie e deri te internacionalizimi i saj. Kandidatët do të njihen me proceset e vendimmarrjes së një blerësi dhe momentet kyçe të vendimeve për blerje, në varësi të industrisë.

20. Menaxhimi i projekteve të TI

Ky modul mbulon fazat, metodat dhe shkathtësitë e menaxhimit të projekteve të TI-së nga fillimi e deri në fund në përfundim dhe dorëzim të projektit, produktit apo shërbimit. Qëllimi kryesor është prezantimi i dokumentacioneve të ndryshme që një projekt duhet të përmbajë, duke filluar nga Project Charter e deri te Finalizimi i Projektit.

Ky modul përgatitë kandidatët për çertifikim në CompTIA Project+.

21. Ndërmarrësia dhe inovacioni

Ky modul ka për qëllim t'i njoftojë studentët me konceptet bazë të ndërmarrësisë dhe inovacionit, me qëllim të stimulimit të menduarit dhe vepruarit si ndërmarrës. Moduli mbulon konceptet e ndërmarrësisë dhe inovacionit, historitë e tyre, si dhe rolin e tyre sot në shoqëri. Gjithashtu, ai trajton teoritë kryesore të ndërmarrësisë dhe inovacionit, dallimin nga menaxhmenti klasik, shtyllat bazë të modeleve të biznesit, burimet e mundshme të financimit të biznesit, ndikimin e teknologjisë dhe internetit në ndërmarrësi, si dhe rastet e studimit nga përvoja e ndërmarrësve të suksesshëm.

22. Testimi i Softuer-it

Qëllimi i modulit është që t'i pajisë kandidatët me njohuritë e nevojshme të teknikave moderne të testimit. Në fund të modulit, kandidatët do të kenë një vlerësim të një sërë teknikave të testimit, do të jenë në gjendje të kuptojnë teknikat e testimit rigoroz dhe të organizuar të softuerit. Ata do të jenë në gjendje për të zgjedhur një strategji të përshtatshme për testim, sajimin e test rasteve (Test Case) të përshtatshme për testim, etj.

Kandidatët do të pajisen me njohuri të nevojshme për përpilimin, raste testimi/test case-ve për nivelet e ndryshme të testimit: 1. module, 2. integration, 3. system, dhe 4. acceptance tests. Kandidatët do të jenë në gjendje gjithashtu që të aplikojnë metodat e testimit si kutia e zezë dhe metoda kutia e bardhë. Po ashtu kandidatët varësisht nga projekti përmes aplikimit të veglave si .NUnit dhe të ndryshme do të arrijnë edhe një testing coverage 100%.

23. Inteligjenca Artificiale

Inteligjenca Artificiale është një modul i fokusuar në bazat e Inteligjencës Artificiale, të nxënit e makinës dhe aplikimet e Inteligjencës Artificiale. Ky modul trajton konceptet e IA, zgjidhjen e problemeve me algoritmet e të nxënit të makinës dhe mjetet e ndryshme që përdoren në IA. Përdorimi i mjeteve të ndryshme të Inteligjencës Artificiale si Inteligjenca Artificiale për Gjenerim, për parashikim. Përfundimi i këtij moduli siguron njohuri dhe aftësi të nevojshme për të përdorur një sistem apo një kornizë të përdorimit të IA.


24. Marketingu Digjital

Ky modul ofron një kuptim të thellë të strategjive dhe teknikave të marketingut digjital në ambientin e tregut të sotëm. Në këtë modul do të mbulohen temat kryesore të marketingut digjital duke përfshirë strategjinë e përmbajtjes, SEO, reklamën në internet, rrjetet apo mediat sociale, analizën e performancës, e-commerce dhe strategjitë e përfshirjes së konsumatorëve në internet.

Mikro-çertifikimet

Kandidatët po ashtu mundën që të ndjekin dhe kalojnë me sukses modulet e caktuara për të arritur në çertifikime që në bazë të Agjendës Digjitale Evropiane quhen mikro-çertifikime.

Modulet e përfunduara



Certifikimi i arritur

Linux sysadmin
Administrator i Sistemit
Linux


Cloud Admin
Administrator i Sistemit Cloud

Networking Specialist
Specialist i Rrjetave

Cyberops Specialist
Specialist i operacioneve
kibernetike

Database Administrator
Administrues i bazave të të
dhënave

Modulet e përfunduara




Certifikimi i arritur

**Network Security Specialist
Specialist i Sigurisë
Kibernetike**

**Penetration Tester
Testues i Sigurisë**

**Information Security Specialist
Specialist i Sigurisë së
informacionit**

Modulet e përfunduara



Certifikimi i arritur

**Security Operation Center (SOC)
Specialist i qendrës së
operacioneve të sigurisë (QOS)**

Na ndiqni në rrjetet tona sociale:<https://www.instagram.com/cactusedu/> <https://www.facebook.com/cactusedu> <https://www.tiktok.com/@cactusedu?lang=en> <https://www.linkedin.com/school/cactusedu/> 

Cactus Education është shkollë e lartë profesionale e nivelit të V e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe e licensuar nga MASHT-i.